

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e cila justifikohet për shkak të disa pikëpamjeve politike shumë të ashpra (radikale), ideologjike dhe/ose fetare.

Kujdes! Ekstremizmi i dhunshëm shkon përtej dhunës në familje! Ekstremizmi i dhunshëm NUK lidhet vetëm me çështjet e besimit fetar!

● ***Vajzat dhe gratë, promovuese të paqes!***

Mit: Vajzat dhe gratë janë thjesht viktima ose të mbijetuara të ekstremizmit të dhunshëm. Përkundrazi, vajzat dhe gratë janë:

- faktorë kyç në nxitjen e ndryshimeve pozitive në shoqëri
- përçuese të vlerave të humanizmit
- komunikuese të denja të paqes
- një zë i fortë kundër padrejtësive dhe dhunës
- lidere të suksesshme dhe gjithëpërshirëse

Për këtë arsye, është e nevojshme fuqizimi dhe mbështetja e vazhdueshme e grave dhe vajzave, me qëllim rritjen e përfshirjes së tyre në shoqëri, në vendimmarrje dhe në dhënien e kontributit për çështje sensitive!

● ***Të rinjtë dhe grupet ekstremiste***

Të rinjtë, fëmijët dhe adoleshentët janë më të rrezikuar për mbështetjen dhe përfshirjen në grupet ekstremiste. Çdo fëmijë apo i ri mund të jetë i ndikuar nga grupet ekstremiste, edhe pse disa prej tyre mund të jenë më të rrezikuar për shkak të faktorëve, të tillë si:

- ✚ Gjendja e vështirë ekonomike
- ✚ Situata politiko-kulturore
- ✚ Papunësia
- ✚ Mospërputhja midis nivelit arsimor dhe statusit të punësimit
- ✚ Të qëndruarit online për një kohë të gjatë

✚ Përrjashtimi social/Diskriminimi

Shenjat paraprake që mund të jenë tregues të përfshirjes në grupe ekstremiste:

- ❖ *Ndryshime të humorit*
- ❖ *Humbje e interesit* për të marrë pjesë në aktivitete sociale
- ❖ Largim nga *familja apo miqtë*
- ❖ Ndryshime në *pamje ose në veshje*
- ❖ Krijimi i *miqësive të dyshimta*
- ❖ Ndryshime të lidhura me *gjendjen financiare*
- ❖ Të folurit në mënyrë të ndarë ‘**ata dhe ne**’
- ❖ Shprehja dhe mbështetja e *ideve ekstremiste*
- ❖ Vendosja e kontakteve me persona të *organizatave ekstremiste*
- ❖ *Përpjekje për të përfshirë* dhe për të bindur të tjerët për t’u angazhuar në grupe ekstremiste
- ❖ Të qenët *i/e fshehtë dhe ngurrues/e* për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen, bashkëpunëtorët
- ❖ Kalimi i kohës së tepërt *në internet ose në telefon*
- ❖ Të pasurit e *disa identiteteve* online
- ❖ Zotërimi i *disa telefonave celularë* ose pajisjeve të tjera
- ❖ Mbajtja në mënyrë *shumë të fshehtë dhe strikte* e pajisjeve telefonike

Si mund të parandalohet ekstremizmi i dhunshëm! Kujdesi dhe paqja fillojnë në shtëpi!

- *Ndani informacion*
- Bisedoni me fëmijët dhe të rinjtë për *aktivitetin e tyre në internet*
- Njihni më nga afër *miqtë e fëmijëve dhe të afërmve tuaj*
- *Realizoni aktivitetet të përbashkëta*, pasi është shumë e rëndësishme që të kaloni kohë cilësore me fëmijët dhe të rinjtë
- Diskutoni mbi *paqen, tolerancën* dhe zgjidhjen e shëndetshme të konflikteve. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që ju të jeni vetë një model i tillë për fëmijët dhe të rinjtë.